

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Antisol® S

AGJENT PËR MATURIMIN E BETONIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Antisol® S është solucion gati për përdorim, i cili formon një izolim mikro-kristalin në poret betonit duke ulur shpejtësinë e avullimit të lagështisë nga miksi i betonit duke ndihmuar kështu në përfundimin e procesit të maturimit.

PËRDORIMET

Sika® Antisol® S aplikohet mbi sipërfaqe betoni të freskët për të formuar një shtresë të papërshkueshme e cila mbron betonin nga avullimi i shpejtë i ujit gjatë fazave fillestare të maturimit.

Sika® Antisol® S rekomandohet veçanërisht për trajtimin e sipërfaqeve vertikale mbi të cilat do të aplikohet trajtim vijues ose mbi të cilat membranat për maturim me bazë rrëshire nuk do të ishin të papërshtatshme.

Sika® Antisol® S është posaçërisht i dobishëm për:

- Ndërtesa
- Industri prodhimi

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sika® Antisol® S ofron vetitë e dobishme të mëposhtme për sipërfaqet e betonit:

- Ndihmon në përgjithësi betonin për të arritur hidratim, fuqi, qëndrueshmëri dhe fortësi sipërfaqësore maksimale
- Përmirëson paraqitjen e sipërfaqes
- Redukton tkurrjen
- Redukton mbledhjen e pluhurit
- Redukton përshkueshmërinë e betonit
- Kur përdoret saktë, nuk ndikohet ndërkapja e trajtimeve vijuese mbi sipërfaqen e betonit

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	fuçi 20 dhe 200 kg
Paraqitja / Ngjyra	Lëng transparent.
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në konteinerin original të pahapur dhe të padëmtuar.
Kushtet e magazinimit	Të mbrohet nga lagështia në temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.
Dendësi vëllimore (bulk density)	~ 1.07 kg / l +/- 0.05

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Konsumimi i Sika® Antisol® S varet nga shpejtësia e erës, temperaturat dhe lagështia gjatë aplikimit. Si një rregull i përgjithshëm, mund të konsiderohet doza prej 0.15-0.20 kg/m ² .
Pajisjet	Sika® Antisol® S mund të aplikohet manualisht ose me pajisje automatike spërkatjeje mbi sipërfaqen e betonit të freskët për të krijuar një cipë/shtresë të vazhdueshme. Për sipërfaqe të mëdha, aplikimi i Sika® Antisol® E mund të kryhet me pajisje automatike që furnizohet me energji elektrike. Pas aplikimit të Sika® Antisol® S duhet të pastrohen të gjitha veglat dhe pajisja e aplikimit.

UDHËZIME APLIKIMI

APLIKIMI

Sipërfaqe vertikale:

Pas heqjes së betoformës, lagni plotësisht betonin me ujë të freskët duke lejuar kullimin e ujërave të sipërfaqes. Pastaj aplikoni Sika® Antisol® S (aplikimi me spërkatje preferohet për mbulim të plotë).

Sipërfaqe horizontale:

Aplikoni Sika® Antisol® S menjëherë pas betonimit dhe pasi të ketë avulluar i gjithë uji mbi sipërfaqe. Sigurohuni se e gjithë sipërfaqja nuk ka ujë dhe nuk është aplikuar më pak së mbulimi i rekomanduar.

DOKUMENTA SHITESË

- Rekomandohet që Sika® Antisol® S të aplikohet sapo sipërfaqja e betonit të jetë gati për të pranuar trajtimin për maturim.
- Për të parandaluar bllokimin, rekomandohet pastrimi i rregullt i pajisjes spërkatëse.
- Pas aplikimit nevojitet mbrojtja e sipërfaqes ku është aplikuar Sika® Antisol® S për të paktën 2-3 orë nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, era e fortë dhe e thatë ose shiu, në varësi të kushteve.
- Cipat e mbetura të Sika® Antisol® S duhet të hiqen përpara aplikimit të llaçit apo veshjes.
- Kur kërkohet rezistencë e lartë ndaj abrazionit për sipërfaqen, p.sh. në kushte të këqija moti, aplikoni një veshje shtesë Sika® Antisol® S pas 3 ditësh. Sistemet vijuese për sipërfaqen mund të aplikohen pas 7 ditësh.

KUFIZIME

Aplikimi i hershëm i Sika® Antisol® S do të ndihmojë në reduktimin e plasaritjeve nga tkurrja, duke ulur sasinë e ujit të avulluar nga masa e betonit. Megjithatë, trajtimet për maturimin e betonit, nuk do të shmangin plasaritjet që mund të ndodhin si rezultat i tkurrjes afatgjatë nga tharja. Duhet të zbatohet praktika standarde e betonimit gjatë pozicionimit të fugave të ndërtimit dhe fugave për kontrollin e tkurrjes.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® Antisol® S
Mars 2019, Botimi 01.01
021405031000000008

SikaAntisolS-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf